

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i
Gjykatës Themelore të Prizrenit
Korrik - Shtator 2014

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur"
Nr. 1, Tetor 2014
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.kgjk-ks.org

PËRMBAJTJE:

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Një dritare e re e transparencës

STORIE E SUKSESIT

Rritet komunikimi mes qytetarëve
dhe gjykatës

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Rritet prezenca mediale

INTERVISTË E SHKURTË

Është zvogëluar dukshëm numri i lëndëve
të grumbulluara (Skënder Çoçaj)

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Cili është jurisdiksioni i Gjykatës?
A e dini se...?!

KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT



Një dritare e re e transparencës

Të nderuar lexues,

Sistemi gjyqësor i Kosovës ka kaluar në një fazë të rëndësishme të tranzicionit, andaj për sundimin e ligjit në Kosovë, është e nevojshme krijimi i parakushteve për funksionim të pavarur, të pa anshëm, dhe profesional, si njëra prej hallkave më të rëndësishme të pushtetit. Një prej elementeve të rëndësishme në funksionimin sa më të mirë të gjyqësorit është edhe bashkëpunimi i gjykatës me qytetarët. Duke e parë si komponentë esenciale të punës, Gjykata Themelore e Prizrenit do të fillojë më publikimin e një buletini informues në baza tre mujore.

Botimi i numrit të parë të buletinit informues mbi punën e gjykatës është ndihmesë në punën tonë, pasi që është edhe një përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës. Ky publikim periodik do të ofrojë informacion mbi punën e gjykatës, statistikën e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen mediale, dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Buletini është një dritare e re e transparencës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Unë shpreh konsideratën më të lartë për të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen dhe botimin e këtij Buletini.

Ymer Hoxha

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren

Rritet komunikimi mes qytetarëve dhe gjykatës

Gjykata Themelore në Prizren i ka të hapura dyert e saj për gjithë qytetarët e interesuar që dëshirojnë të vizitojnë dhe të mësojnë më shumë për gjykatën e tyre. Komunikimi i qytetarëve me shërbyesit e drejtësisë është një parakusht për krijimin e besimit në drejtësinë që ndahet në këtë gjykatë dhe e mban të informuar gjykatën për kërkesat që kanë qytetarët. Me qëllim të rritjes së këtij besimi të ndërsjellë, Gjykata Themelore në Prizren në bashkëpunim me OJQ EC Ma Ndryshe, organizon rregullisht aktivitetin "Vizitë në Gjykatë", duke e rritur më tej komunikimin mes qytetarëve dhe kësaj gjykate. Në këto vizita, qytetarët kanë mundësinë që të njihen për së afërmi me ambientin e gjykatës, sallat e gjykimit, punën e administratës dhe gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme. Në njërën prej sallave të gjykimit qytetarët priten edhe nga Kryetari i gjykatës, me ç'rast diskutohet për kërkesat, nevojat dhe shqetësimet që kanë të dyja palët në raport me gjykatën dhe drejtësinë.



LAJME

Projekt i ri i Gjykatës

Gjykata Themelore e Prizrenit është në bashkëpunim të ngushtë me OJQ EC Ma Ndryshe për implementimin e projektit "Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë" që mbështetet nga USAID dhe mbikëqyret nga ATRC. Përmes këtij projekti synohet përmirësimi i komunikimit midis qytetarëve dhe gjykatës me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në sektorin e drejtësisë dhe rritjen e besimit të tyre në sistemin e drejtësisë. Për këtë arsye janë hapur faqet e projektit/gjykatës në rrjete sociale me emrin "Gjykatë e Hapur", të cilat në baza ditore paraqesin informacionet e rëndësishme për gjykatën, si tabelën e seancave gjyqësore, kumtesat për shtyp, përfshirjen mediale të gjykatës, vizitat, debatet, kontaktet e gjykatës, etj.

Debati "Gjykata dhe qytetarët"

Gjykata Themelore në Prizren, në bashkëpunim me EC Ma Ndryshe, organizoi debatin me qytetarë të titulluar "Gjykata dhe qytetarët". Debati kishte synim të nxisë komunikimin mes qytetarëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren. Për të diskutuar me qytetarët, në këtë debat të pranishëm ishin: Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren, Afërdita Kicaj, Zëdhënëse e Gjykatës Themelore në Prizren, Naim Kurtishi, gjykatës civil, Skender Çocaj, gjykatës penal dhe Sefer Gutaj, gjykatës për kundërvajtje.



Vizitë e zyrtarëve të USAID/EROL dhe USAID/CLE

Me 8 gusht 2014, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan përfaqësuesit më të lartë të USAID/EROL dhe USAID/CLE. Përfaqësuesit u shoqëruan nga Kryetari i gjykatës Z. Ymer Hoxha, i cili i njoftoi për punën e Gjykatës, dhe funksionimin e saj pas strukturës së re të gjykatës, investimet e bëra në objektet e gjykatave model në Gjykatën Themelore në Prizren si dhe degët Suharekë dhe Dragash, dizajnimin sipas standardeve, etj. Në këtë takim gjithashtu u bisedua për punën dhe për sfidat me të cilat përballlet Gjykata, nevojën për ndërtimin e një objekti tjetër të Gjykatës, apo ngritjen edhe të një kati në ndërtesën aktuale.

Vizitë e grupit të fëmijëve në Gjykatën Themelore në Prizren

Gjykata Themelore e Prizrenit ishte nikoqire edhe e një grupi të fëmijëve nga Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit. Në gusht të këtij viti, në kuadër të aktivitetit "Të luajmë duke mësuar, të mësojmë duke luajtur", rreth 40 fëmije dhe 5 bartës të projektit vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit. Fëmijët patën mundësinë të njihen me gjykatën e tyre dhe të mësojnë më shumë rreth funksionimit të saj. Në fund ishte edhe sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve ku, fëmijët shfaqën kureshtjen e tyre për punën e gjykatës, duke i adresuar pyetjet zyrtares për informim të Gjykatës Themelore të Prizrenit.



Komuniteti informohet për të drejtën e gruas në trashëgimi

Më 12 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren dhe EC Ma Ndryshe mbajtën debatin e rradhës mes qytetarëve dhe përfaqësuesve nga gjykata, me temën "E drejta e gruas në trashëgimi". Debatu kishte synim të nxisë diskutimin mes qytetarëve, panelistëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren për konceptet themelore të trashëgimisë me testament dhe me ligj, me theks të veçantë për gratë. Për të diskutuar me qytetarët në këtë debat, të pranishëm ishin: Mehmet Ndrecaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe Valbona Salihu, nga Shoqata e Juristeve NORMA. Lexo komunikatën.



Njëzetë praktikantë përfunduan praktikën në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Gjykata Themelore e Prizrenit, për herë të parë ka pranuar një numër kaq të madhe të praktikantëve, duke i angazhuar nëpër departamente të ndryshme në gjykatë. Njëzet praktikantët e angazhuar përgjatë një viti kanë përfunduar me sukses praktikën në këtë gjykatë. Me këtë rast, Kryetari i Gjykatës Z. Ymer Hoxha i ka falenderuar praktikantët për punën dhe angazhimin e tyre maksimal gjatë kësaj periudhe në këtë institucion. Ai ka potencuar se "Praktikantët kanë qenë gjithmonë të gatshëm për t'i kryer punët për të cilat kanë qenë të angazhuar, dhe përvoja për një vit në gjykatë, do të ju shërbejë në karrierën profesionale".



Gjykata me mjete të reja komunikimi me qytetarët

Në një konferencë për media, Gjykata Themelore e Prizrenit ka promovuar produktet e reja të cilat kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe forcimin e komunikimit me qytetarët: Strategjia e Komunikimit e Gjykatës, fletushka "Si t'i qasemi gjykatës?" dhe video spoti "Gjykatë e hapur". Strategjia e Komunikimit vë në zbatim planete konkrete për të nxitur transparencën, krijimin e një lidhje të fuqishme me qytetarët dhe vënien në përdorim të mjeteve dhe teknologjisë së re për të forcuar lidhjen e gjykatës me qytetarët. Produkti i dytë që u promovua është fletushka "Si t'i qasemi gjykatës?", që përmban informacione relevante për punën e gjykatës dhe të drejtat e qytetarëve. Së treti, gjykata ka prezantuar spotin e shkurtër televiziv, që ka përmbajtje informative për punën e gjykatës duke synuar informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre karshi gjykatës.



GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela më poshtë paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014, si ato të trashëguara nga viti paraprak, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë gjashtë mujor dhe ato të mbetura. Edhe për këtë periudhë raportuese, numrat janë dëshmia e rradhës e përkushtim maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren	Lëndët e trashëguara në fillim të 2014	Lëndët e ardhura gjatë 6 mujorit 2014	Gjithsej lëndët në punë gjatë 6 mujorit 2014	Lëndët e kryera gjatë 6 mujorit 2014	Lëndët e mbetura në fund të 6 mujorit 2014
Departamenti për Krime të Rënda	424	298	722	278	444
Departamenti i Përgjithshëm	21695	4426	26121	5216	20905
Departamenti për të mitur	310	161	471	166	305
Divizioni i Kundërvajtjes	9846	18914	28760	19923	8837
Totali	32275	23799	56074	25583	30491

Rritet prezenca mediale

Përveç komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarë, një nga elementet që ndikon në hapjen e gjykatës dhe rritjen e nivelit të informimit të qytetarëve për punën e këtij institucioni është edhe paraqitja mediale e aktiviteteve të gjykatës. Ky kapitull i buletinit do të mbulojë në baza të rregullta raportimin e mediave rreth punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, duke paraqitur raportet mediale rreth aktiviteteve të ndryshme të kësaj gjykate por edhe artikujt që trajtojnë çështje që lidhen me punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Aktivitetet e gjykatës kanë gjetur vend të konsiderueshëm në media, si në ato lokale dhe qendrore me rreth njëzet paraqitje të lajmeve të ndryshme për punën e kësaj gjykate. Mediat që kanë përcjellur punën e gjykatës janë: TV Prizreni, TV Opinioni dhe TV Besa, Gazeta Zëri, Koha Ditore dhe Kosova Sot, portalet e ndryshme si Prizrenpress, 04 Online, etj. Nga janari deri në tetor të vitit 2014, Gjykata Themelore e Prizrenit ka lëshuar rreth gjashtëdhjetë kumtesa për media.



INTERVISTË E SHKURTË

Është zvogëluar dukshëm numri i lëndëve të grumbulluara



SKËNDER ÇOÇAJ

Gjykata Themelore e Prizrenit është e përkushtuar në rritjen e bashkëpunimit me të gjitha grupet e komunitetit dhe beson fuqimisht në domosdoshmërinë e rritjes së informimit dhe pjesëmarrjes qytetare për të siguruar punë transparente dhe rritur cilësinë

e shërbimeve të ofruara. Me një përkushtim të tillë, punon edhe Skënder Çoçaj, Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe gjyqtar në lëminë penale, në Gjykatën Themelore të Prizrenit, të cilin e ftuam për intervistën e shkurtë të këtij numri.

1. Sa sfiduese është puna juaj?

Sfidat në punën e gjyqtarit janë kryesisht të natyrës profesionale, por edhe të lidhura me ndryshimet e shumë ligjeve gjatë kësaj periudhe të tranzicionit. Sfidues vazhdon të jetë numri i lëndëve në njërën anë dhe kontakti me qytetarë në anën tjetër. Lëvizja e popullatës, ndryshimet në pronësi, investimet e shumta, janë sfiduese me faktin që duhet të merremi për një kohë të shkurërt me shumë çështje të ndryshme.

2. Cilat parime i ndjekni gjatë ndarjes së drejtësisë?

Ne jemi të obliguar t'i zbatojmë parimet etike dhe ato profesionale. Një gjyqtar duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur nga ndikimet që mund të vijnë nga adresa të ndryshme. Gjyqtari duhet të jetë objektiv, t'i trajtojë të gjitha palët njësoj,

pavarësisht nacionalitetit apo gjuhës që flet. Gjithashtu, gjyqtari gjatë punës së tij, udhëhiqet edhe nga parimet tjera siç janë: parimi i gjykimin të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, prezumimi i pafajësisë, parimi i publicitetit, parimi i kontradiktorialitetit.

3. Pse ka shumë lëndë të grumbulluara në gjykatat tona?

Gjykata Themelore në Prizren nuk mund të quhet një gjykatë e stërngarkuar me lëndë. Me një organizim të ri të gjykatave në Kosovë dhe angazhim të shtuar të gjithë stafit të gjykatës, po arrijmë që të zvogëlojmë dukshëm numrin e lëndëve. Lëvizja e qytetarëve, përkatësisht dalja jashtë Kosovës, është një prej problemeve që shkakton vonesa në zgjidhjen e një lënde.

4. Pse perceptimi i qytetarëve deri vonë nuk ka qenë pozitiv për punën e gjyqësorit?

Është e vërtetë që perceptimi nuk ka qenë pozitiv, kjo për arsye se qytetarët nuk kanë gjetur zgjidhje të shpejtë në gjykatë, si për shkak të numrit të madh të lëndëve e numrit të vogël të gjyqtarëve, mos bashkëpunimit adekuat të institucioneve tjera me gjykatat, etj. Gjykata tani ka Zyrën për Informim dhe

zyret në gjykatë janë rregulluar ashtu që të jenë më transparente, për këtë arsye ka filluar dukshëm ndryshimi i perceptimit të qytetarëve për gjykatën, në aspektin pozitiv.

5. Si mund të përmirësohet bashkëpunimi me qytetarët dhe imazhi i gjyqësorit para tyre?

Bashkëpunim me qytetarë veç ekziston, në aspektin e asaj që kur një qytetar i Prizrenit vjen në gjykatë, do ta gjej informacionin e duhur. Në aspektin e publicitetit i kemi fletushkat në këndin e informacionit, kemi monitorin e seancave ku publikohet secila seancë gjyqësore, te cili gjyqtar e në cilën sallë mbahet, po ashtu edhe faqja në facebook me emrin "Gjykatë e Hapur" me të gjitha informacionet. Seancat gjyqësore që i lejon ligji janë publikuar dhe çdo qytetar i interesuar mund të vijë dhe të përcjell gjykimin, edhe zyrtarët poshtë janë gjithmonë të gatshëm të ju përgjigjen qytetarëve për kërkesat dhe pyetjet e tyre.

Gjykata është vendi ku qytetarët mund ti realizojnë të drejtat e tyre, jemi këtu të punojmë në mënyrë që qytetarët t'i realizojnë të gjitha të drejtat e tyre.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Cili është jurisdiksioni i Gjykatës?

Gjykata Themelore është gjykata e parë ku ju i filloni procedurat tuaja gjyqësore. Gjykata Themelore e Prizrenit ka jurisdikcion të përgjithshëm, që do të thotë se ajo i gjykon të gjitha çështjet në shkallë të parë përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Gjykata Themelore në Prizren ka tri departamente dhe një divizion:

- Departamenti i Përgjithshëm, i cili merret me shumicën e lëndëve penale dhe civile
- Departamenti për të Mitur, i cili merret me lëndët në të cilat janë të përfshirë kryerësit e mitur,
- Departamenti për Krime të Rënda, i cili merret me lëndë që ceken në Nenin 15 të Ligjit për Gjykata dhe në Nenin 22 të

Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dhe

- Divizioni i Kundërvajtjes, i cili mirret me rastet e kundërvajtjeve,

A e dini se...?!

1. Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. (LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT, Neni 7)

2. Kryetari i gjykatës është i obliguar që të pranojë palët dhe të përgjigjet në pyetjet e tyre apo shqyrtojë ankesat e tyre. Për këtë qëllim, gjykata organizon "Ditët e Hapura", për të cilën qytetarët mund të parashtrojnë kërkesë për pjesëmarrje. "Dita e Hapur" në Gjykatën Themelore në Prizren, mbahet çdo dy javë, të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji.



KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29/244 122

ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

VIZITO:

www.kgjk-ks.org



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Ky dokument është hartuar nga EC Ma Ndryshe për Gjykatën Themelore të Prizrenit, në kuadër të projektit Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë, që përkrahët financiarisht nga USAID dhe mbikëqyret nga ATRC.

"Ky dokument u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara".